

VENDIM
Nr. 5, datë 23.11.2023

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 5, DATË 2.4.2019, TË KËSHILLIT PËR
EMËRIME NË DREJTËSI, “PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E VLERËSIMIT,
PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË KANDIDATËVE, PËR POZICIONET VAKANTE
NË GJYKATËN KUSHTETUESE DHE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 229, dhe të pikës 6, të nenit 240, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (i ndryshuar), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 5, datë 2.4.2019, të Këshillit për Emërime në Drejtësi, “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, bëhet shtesat e mëposhtme:

1. Pas pikës 15, shtohet pika 15/1, me këtë përmbajtje si vijon:

“15/1. Për kandidatët të cilët kanë aplikuar në më shumë se një vakancë për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, Këshilli duhet të bëjë vlerësimin dhe pikëzimin njëkohësisht në të gjitha vakancat.

Në rast pamundësie të vlerësimit dhe pikëzimit njëkohësisht për të gjitha vakancat, pasi shkelen afatet ligjore, Këshilli bënë vlerësimin dhe pikëzimin individualisht për secilën vakancë. Në këtë rast kandidati i vlerësuar dhe i pikëzuar për njëërën vakancë nuk i nënshtrohet më kësaj procedure për vakancat e tjera. Përfundimisht, kur kandidati i pikëzuar më parë, arrin të sigurojë dokumente të reja mbas momentit të vlerësimit të mëparshëm dhe që i shërbejnë vlerësimit të tij, Këshilli për këtë komponent bën rivlerësimin dhe ripikëzimin përkatës. Dokumenti i ri duhet të paraqitet të paktën një ditë përpara nga dita e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit për përcaktimin e pikëzimit të kandidatit. Dokumentacioni që zotërohet nga kandidati dhe që nuk është paraqitur më parë për vlerësim, nuk do të merret më në konsideratë edhe nuk do të bëhet pjesë e rivlerësimit nga Këshilli.”

2. Pas pikës 18, shtohet pika 18/1, me këtë përmbajtje si vijon:

“18/1. Kandidati ka detyrimin ligjor që të jetë bashkëpunues, korrekt dhe të mos kryejë veprime që zvarrisin pa arsye procesin e vlerësimit dhe pikëzimit. Sjellja e tij/saj në raport me procesin e vlerësimit do të jetë pjesë e vlerësimit nga Këshilli. Kandidatët për çdo pretendim apo për paraqitjen e dokumentacionit, duhet të respektojnë afatet e caktuara nga relatori dhe gjithmonë jo më vonë se 2 ditë para mbledhjes ku do të shqyrtohet kandidatura konkrete.”

3. Në pikën 66, mbas fjalisë së parë, shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon:

“Çdo anëtar i Këshillit duhet të argumentojë, për secilin kriter vlerësimi, masën e pikëve që i ka caktuar kandidatit.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Sandër Simoni

Zëvendëskryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Fuat Vjerdha, Arta Marku, Arqilea Koça, Engert Pëllumbi, Gjon Fusha, Enerjeta Shehaj